

Ognjen Spahić

Fëmijët e Hansenit

Titulli i origjinalit: Ognjen Spahić, Hansenova djeca  
Durieux, Zagreb,  
Otvoreni kulturni forum, Cetinje 2004.

Lektorimi letrar: Silvana Leka

Realizimi grafik dhe ballinat: Geppetto's Studio  
Imazhi në ballinë: Omer Kaleshi

Copyright i këtij botimi "Botimet Poeteka", 2017

ISBN 978-9928-230-03-4

Copyright © of the translation: S. Fischer Foundation by order of  
TRADUKI

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Europë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Zyra e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni zviceran "Pro Helvetia", "KulturKontakt Austria" (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë), Instituti "Goethe", Agjencia Slovene e Librit "JAK", Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni "S. Fischer".

traduki 

Botimet Poeteka  
Rr. "Frederik Shiroka"  
K.II, Kt. 2, Tiranë  
[infopoeteka@gmail.com](mailto:infopoeteka@gmail.com)  
<http://poeteka.blogspot.al>

Shtypshkronja

  
INTERGRAFIKA  
[www.intergrafika.net](http://www.intergrafika.net)

Ognjen Spahić

# Fëmijët e Hansenit

Përktheu nga origjinali:  
Janka Selimi, Milena Selimi



BOTIMET POETEKA



*Me borën e ngathët zbresin lebrozët.*

Rene Char

nga poezia “Fitorja e dritës”

I fundmi i spitaleve të lebrozëve në Evropë ndodhet në juglindje të Rumanisë, midis peizazheve po ashtu lebroze të tokës së errët, shterpë, përshkuar nga oxhaqet e trashë të termocentraleve dhe mbeturinat e pyjeve dikur të mëdhenj. Toka pjellore, e cila nuk ekziston aty prej kohësh, mban mend hapat e rëndë të kalorësve dakianë, Borebistës dhe Decibalas, gjithmonë të gatshëm t’i ngulin shpatat në vithet e shndritshëm të kuajve romakë e në të gjitha barqet e ngopura dhe të bëshëm të legjionarëve trajanas. Vladi III Çepesh dhe Mirça Stari, Stefani i Madh, atlet i krishterimit moldavian dhe Mihajlo Sypatremburi ishin apostujt besnikë të fjalës së Zotit, dikur konstelacion yjesh, i cili shihej me sytë plot shpresë, teksa shpatat e shtrembra otomane derdhnin lumenj gjaku të rinjsh.

Historia e vjetër e kësaj toke ishte kryqëzuar - dhe këtë shumë njerëz dëshirojnë ta thonë - midis kthetrave të luanëve të vjetër dhe të ligj, krifat e të cilëve janë të përlyera prej kufomave të miliona të nënshtruarve.

Por, Rumania nuk e ka harruar lavdinë e trimave. “Lumenjtë rrjedhin, por shkëmbinjtë mbeten”,

thotë një fjalë e urtë rumune, edhe sot mund të dëgjoni kujtime që flasin për veprat heroike të legjionit të Çepeshit, të vendosur t'i falen tokës amtare deri në pikën e fundit të gjakut.

Shokut tim të dashur të dhomës, Robert W. Dunkan, i pëlqen të thotë se historia është syri i tretë i njerëzimit dhe se me të mund të shihen qartë strofkat e pakapshme të kohës sonë melankolike. Gjithmonë përgjigjem duke cituar Emil Cioran-in, i cili shkruan se në botë, bilbilët i piqnin në zgarë pa melankoli, kurse R.W. Dunkan shton pastaj se e josh mendimi për bilbilin e rrjepur, të marinuar me mente dhe hudhër dhe më thotë të mos e përmend më atë situatë të sëmurë. Filloj të vërshëllej përmes dhëmbëve të rrallë, lëviz me duar, sillem nëpër dhomë, derisa R.W.D të kapë pandoflat dhe të m'i hedhë surratit. Ai kërkon të flejë. Ndërsa unë nuk mundem.

Kisha dëshirë të rri në dritare, ndërkohë që në mendjen time kalonin copëza të historisë së bërë pluhur të cilat, pas mbrëmjeve të thata verore, vijnë me erën e freskët nga Karpatet, ose me atë të ngrohtin që fryn njëtrajtshëm, duke zbritur nga shpatet shkëmbore të Alpeve të Transivalnisë. Po ndiej aromën e pyllit dhe të boronicës, erën e fushave të harlisura, lulen e shkurreve të jargavanit; copëza e gurit shkëmbor, që më kërcet nëpër dhëmbë, më bën të ndiej shijen e shkëmbinjve që ngulen thikë në hijen e bukur të kataraktit. Kur

mbyll syrin e djathtë, i cili pëlçet gëzueshëm nga shëndeti, mbi peizazhin zbret perджа e mjegullës: Hëna bëhet një çamçakëz i shtypur, ndërsa shoku i dhomës edhe më i fjetur. Dritat ngjyrëviolet e fabrikës së afërt të plehut inorganik dridhen si yje që vdesin, ndërsa busti i mermertë i Aleksandrit Ioan I, vendosur në mes të oborrit spitalor, mezi dallohet. Hap të djathtin, mbyll të majtin. Shkel njërin sy, pastaj tjetrin. Ul dhe ngre qepallat duke shijuar - privë-dualizmin e botës.

Faqet që vijojnë janë të shkruara me syrin e djathtë, me pjesëmarrjen e palëkundur të arsyes dhe ndërgjegjes.

Njerëzit që kam takuar dhe njohur në rrugën time - merrni me mend se për Decibalin dhe Borebishtin, ose dhe për mbretin Ioan, nuk mund të them asgjë nga dora e parë - do të përshkruhen ashtu si ma thotë ndërgjegja. Ata që nuk i kam takuar, por që në lojë e sipër, ose rastësisht janë bërë pjesë e pandarë e jetës sime, do të përpiqem t'i rikrijoj me fjalë, duke u kujdesur që, asnjë fjalë e përfshirë të mos lerë shenjë, që të shëmtojë bukurinë e pastër të së vërtetës.

## Kapitulli i parë

Data gjashtëmbëdhjetë prill, 1989. Çohem para të gjithëve. Mendoj të mbledh disa lulenarcizë ende të paçelur, që rriten pranë murit jugor të spitalit. Dëshiroj t'i hapin petalet në dhomën time, prandaj zbres dy palë shkallë nga kati i dytë, duke mbajtur një kuti konservash, plot me ujë. Një natë më parë ka qenë e mbushur me feta ananasi, të cilat i hëngrëm me kënaqësi me Robertin. Ky frut shmangte rregullisht vëmendjen e doganierëve dhe të fshatarëve të uritur rumunë dhe, pasi ata shijonin nga pak të gjitha ushqimet në paketën e ndihmës së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, në fund të kutive të mëdha mbeteshin vetëm konservat me frutin e lëngshëm tropikal. Mendoj se këtu bëhej fjalë për një paragjykim në lidhje me ushqimin e tipit: kafja nga Republika e Afrikës së Jugut ka radioaktivitet, ose, mollët nga Zelanda e Re kanë ngjyrë artificiale...

Ishte bukur të shikosh shpatet me dëborë të maleve të largëta duke menduar për duart e vajzave të Karaibeve dhe për gishtat që, vetëm disa muaj më parë, kanë ledhatuar lëkurën e ashpër të



frutit, zemrën e të cilit jemi duke e shijuar vërtet. Ndërkohë që përtypim ananasin dhe, me mendje po lëpijmë ato duar të buta, nuk më vjen turp të them se, duke e kafshuar, shpeshherë kam përjetuar një ereksion të këndshëm. Narcizët duhen këputur para diellit, rrezet e të cilit tashmë prekin vijën e përkultë të tymit mbi fabrikën e plehut inorganik. Kështu i këpusni, ndërkohë që ende po flenë dhe i zhvendosni në një shtrat tjetër. Uji i ftohtë i mban të freskëta disa javë dhe ato do të lulëzojnë çdo mëngjes.

I ndaja nga toka dukë e këputur kërcellin një centimetër mbi sipërfaqe. Është e rëndësishme të mos dëmtohet qepujka e madhe, sepse ajo fsheh ende brenda vetes shumë lule të verdha për vitet që vijjnë. Për varret me kockat lebroze të miqve të mi. Që nga viti 1981 na varrosin përreth spitalit, për të shmangur kështu shpenzimet e transportit deri në krematoriumin e Bukureshtit dhe dërgimin e urnave tek farefisët e shpërndarë kontinenteve. Më kujtohet se ky ndryshim nuk shkaktoi zemërim të dukshëm, sepse të gjithë – duhet të them sëfundmi se ne lebrozët - këtu kalonim ditët, falë farefisit të frikësuar nga sëmundja jonë e moçme. Sepse, lebra, në ndërgjegjen e njerëzve, më shpesh shkaktonte dy gjëra: 1. kuadro nga Ben Huri i Vajlerit (Wylor) Me koloni të lebrozëve të cilët sillen nëpër planetë si të ndëshkuar nga Zoti, të përbuzur dhe të dënuar me një vdekje të dhimbshme në vetmi, shpellave

larg qytetit; 2. frikë nga përbindëshi biologjik në fillim të shekullit të njëzetë i cili, në atë kohë, zbriti si një gabim fatal i natyrës, ose falë drejtësisë së perëndisë së gjithfuqishme: Besonin se gungat tona të zbehta mishtore, se qelbëzimet nëpër shpinat, duart dhe qafat tona përmbajnë farat e sëmundjes, të gatshme të hidhen në botë duke përhapur gjerësisht nëpër botë, më të vjetrën e sëmundjeve. Fshatarët e trashë rumunë, me ndërgjegje të sëmurë, nga frika irracionale dhe paragjykuese, na shihnin si mbeturinë e fisit njerëzor të egërsuar, ata i mbronin fëmijët e tyre të shëmtuar dhe i lejonin të luanin vetëm njëqind metra larg rrethimit të Lebrozoriumit.

Gjithmonë kam patur përshtypjen se godina jonë dhe rrethina e saj shikohej më shumë si një varrezë e vjetër e mallkuar, ku zvarriten shpirtra, sesa si një institucion mjekësor. Për këtë, besoj kanë kontribuar dhe rrobat tona të gjata prej liri: mbrojtje e domosdoshme nga dielli dhe nga shikimi i të sëmurëve. E kam fjalën: të paktën nga shikimi i atyre që kishin sy.

Çdo lebroz dëshiron të dijë në ç'mënyrë janë shëmtuar trupat e të tjerëve. Kjo është një temë standarte e bisedave sy ndër sy, në disa raste ndër tre sysh, ose, ndër dy sysh. Vendet më të ndjeshme janë organet seksuale mashkullore, në fazat e caktuara të sëmundjes, mjaft të ngjashme me rënien e tharë të sanës, ose përpara kësaj, gishtave të shtrembëruar

të papërdorshëm të pleqve. Gjendja e kësaj pjese të trupit, përcaktonte në heshtje statusin e pacientit në koloni.

Kam patur fatin e rrallë që mashkulliteti im të mbetet i paprekur nga “magjia e bacilit Gerhard Armauer Hansen”. Duke qenë se edhe përpara sëmundjes kam qenë mjaft i dalluar te përmasat; pozicioni i rrefimtarit tuaj shumë shpejt pas ardhjes u përcaktua me statusin e liderit, që diçka thoshte në këtë vend.

Mua më thërrasin të vendos kur duhet të ndahet ndihma e komunitetit katolik, e lënë tek porta dhe të vlerësohet sa dru duhen harxhuar për ngrohje, të zgjidhet lloji i patateve dhe ndarja në pjesë të barabarta. Në të shumtën e rasteve nuk ka problem. Asnjëri nuk revoltohet, ose nuk ka fuqi mjaftueshëm për një gjë të tillë. Pakënaqësitë shprehen me mërmëritje nën kapuçët e lirtë, ose me zënka të vogla në korridoret e errta të godinës. Por, ndonjëherë, gjërat dilnin jashtë kontrollit, çka parashikonte marrjen e masave radikale, me pëlqimin e të sëmurëve të tjerë. Ergo: Cion Eminesku i bie me dru kokës Mstislav Kasjević-it, e gjithë kjo për keqkuptimin rreth sasisë së domateve që u është dhënë. Atëhere duhej të reagonim shpejt dhe me drejtësi.

Pa dashje hapja derën e ambientit të bodrumit numër 42, i cili, me vendim të përbashkët ishte shpallur burg i mundshëm, në rast të sjelljes së

palejueshme. Gjatë qëndrimit tim në *Lebrozorium*, e kam hapur gjithsej katër herë. Fatkeqësi Cion kaloi një natë të merituar në numrin 42, por në mëngjesin e të nesërmes nuk pranoi të dilte, i prekur nga dënimi. Kur Mstislav Kasjević-i i ofroi me shpirtmadhësi të dënuarit pjesën e vet të perimes së lëngshme e të kuqe, Cioni doli jashtë me dënësë. Armiqtë u përqaftuan ngrohtësisht dhe gjithçka u kthye në gjendjen e zakonshme të gjërave.

Përqaftimet e ngrohta të Mstislav Kasjević-it dhe Cion Eminescu-t, më vonë, në intimitetin e dhomës me tavan të lartë kanë vazhduar mbi dyshekët e mbushur me lesh të mykur, në banjën dhe korridoret qorre të *Lebrozoriumit*. Nuk e kam kuptuar si e përballonin shëmtinë e trupave mjaft të shkatërruar nga sëmundja. Cionit i mungon hunda, në vend të saj ka një zgavër të errët, në të cilën mund të fusnit të paktën dy gishtat. Pjesa tjetër nuk ishte më tërheqëse. Këmba e djathtë, pa shputë, tërhiqet në tokë si cung, ndërsa nën rrobën e lirtë në kurriz dallohen gunga jashtëzakonisht të mëdha të mishit të ngurtësuar.

Kasijeviç vuan nga një lloj gjymtimi tjetër. Shenjat e fytyrës janë si numër, por të prekura janë kyçet e të gjitha ligamenteve. Kjo e bën ecjen e Mstislav-it t'i ngjajë lëvizjes së kukullave *overdimension* në ankthet më të zeza të fëmijëve. Sido që të duket marrëdhënia seksuale e këtyre fatkeqëve, jam i sigurt se M.K asnjëherë nuk ka qenë në gjunjë.

Pakënaqësia e parë në marrëdhëniet e tyre filloi për arsye sa krejtësisht pragmatike, aq edhe të pakuptimta. Numri tridhjetëegjastë i “Lajmëtarit mjekësor” - janar 1984, botuar në Bukuresht, nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara, njoftoi në mënyrë bombastike për *një sëmundje të re, e cila do të ndryshonte faqen e botës*. Në ditët që pasuan, të gjithë i rilexuan faqet e kushtuara AIDS-it, disa me nënqeshje, të tjerët me indiferencë mospërfillëse. Vura re se shfaqja e përbindëshit të ri biologjik shkaktoi dhe një dozë të caktuar zilie. Ndihej se lebra gëzonte një respekt të çuditshëm tek viktimat e saj. Gjatë grindjeve të hidhta në oborr shpërthenin fjalë të pamenduara, të përbuzjes dhe urrejtjes, me të cilat AIDS-in e quanin një farsë mediatike, me synimin të diskualifikohen përbindshat si murtaja, kanceri, sifilizi dhe sigurisht, lebra. Ata e donin sëmundjen e tyre duke e nderuar si armik të denjë. Nga AIDS-i më shpesh sëmuren narkomanët intravenozë, hemofilët dhe homoseksualët - po lexonte me zë të lartë Ingemar Zoltan. Ndërsa të tjerët tundnin kokat në shenjë aprovimi, duke pëshpëritur mes tyre, ku jo rastësisht dëgjoheshin emrat: Cion dhe Mëstislav. Pas këtij njoftimi, qëndrimi ndaj dashnorëve ndryshoi mjaft. Duke mos kuptuar natyrën e sëmundjes së re, besonin se ajo ishte një pjellë e keqe e homoseksualizmit. U largoheshin Kasjeviçit dhe Eminescut, sikur të ishin...Desha të them - lebrozë. Duhej t'i kuptoje.

Ai që nuk ka njohur me imtësi natyrën delikate të trupit dhe mendjes së gjymtuar nga lebra vështirë do të kuptojë sjelljen në dukje irracionale, e cila, brenda vetes, shpesh herë fsheh shtytje, të ndryshme nga ato që do të mendonin si njerëz që i përkasin botës tjetër, botës së jolebrozëve. Diagnoza vlen dhe për rastin e ex-komunikimit të Cionit dhe Mstislav-it, rëndësia e së cilës u zmbrafs para zhurmës rreth sëmundjes së re dhe të ashtuquajturve apostujve të saj, homoseksualëve. Rregulli, të cilin, të dhënat edhe faktet kanë formuluar ndër vite, fliste se në *Lebrozorium* nuk mundet dhe nuk duhet të ketë emocione. Të gjithë jemi një trup, i cili merr frymë me sëmundjen, fle me të dhe vdes nga të njëjtat shkaqe. Marr guximin ta quaj këtë mekanizëm praktik, pjesë e forcës së ekuilibrit natyror drejtuar ruajtjes elementare të shëndetit të brishtë fizik dhe mental të racës njerëzore.

Asgjësimi i organit të seksit zhduktte instiktin e riprodhimit dhe kështu, mundësitë e ngjizjes brenda bashkësisë së të sëmurëve.

Në *Lebrozoriumin* tim, mes njëmbëdhjetë burrave, kishte edhe një pothuajse grua.

I detyrohem këtë paqartësi ruses së vjetër, Margaretës Josipović, e cila, që kur unë mbaj mend ditët e spitalit, ndodhej në gjendje gjysmë letargjike. Prej vitesh nuk dilte nga dhoma, ndërsa vdekja nuk trokiste në derën e saj. Vetëm unë trokisja njëherë

në javë; dhe, pasi prisja me durim që damarët e zërit të nxirrnin një murmërimë të mbytur, hyja për t'ia matur pulsën dhe për t'i hedhur disa lugë supe në fyt. Margareta ma kthente me rrëfime: me kujtime që shkonin deri në ditët e fundit të Ruisë cariste dhe gulagut të egër në tundrën siberiane, si dhe në historinë e hershme të Lebrozoriumit, pas hapjes së tij.

Zëri i ngjirur i vinte thellë nga barku, duke u përhapur në dhomë në frekuenca të ulta. Pas dhjetë minutash, kisha përshtypjen se e dëgjoja nga të gjitha anët. Tregonte rrjedhshëm, me një ton të njëtrajtshëm, i cili të kujtonte tingullin e pllakës së vjetër të gramafonit.

Rusishtja e saj nganjëherë po më çmendte. Fliste për kohën e carit, duke përdorur plot terma arkaike dhe mbiemra ekzotikë, të cilat, dijet e mia gjuhësore të shkollës, i grryenin deri në rrënjë. Nëse tregonte për Rusinë e Kuqe, atëhere marshonin kolona makinash me emra të bujshme të komiteteve të ndryshme dhe tituj të punonjësve të vegjël stalinianë, të cilët nëse e kam kuptuar mirë, ishin fajtorë që bytha e saj dhe e burrit të saj hëngrën me vite të ftohtin siberian. Margareta Josipović, në gulagun numër 32 - A fitoi edhe bacilin e Hansenit. Nën barrën e rëndë të lebrës gruaja e guximshme arriti të ruajë shëndoshë mendjen e saj deri në ditën e fundit. Duke hequr dorë ndërgjegjshëm nga trupi për hir të mëshirës së kolegëve të sëmurë,

Margaret Josipović kaloi dhjetë vitet e fundit duke notuar në detin e errët të kujtimeve, gjithmonë duke u ankuar nga ai i ftohti siberian që kishte gjetur strehë përgjithmonë në rradaken e saj.

Vuajtjet e të tjerëve dhe të miat fillonin me agimin. Vija e përparëseve blu të punëtorëve shkon në punë, kurse ju e prisni ditën me dhimbje të intensitetit të ndryshëm. Komunikimi me dritën më shpesh fillonte me zbulimin e ndryshimeve të reja në trup. Sipas rezultateve, gjendja juaj do të kalojë nga depresioni vrasës, deri në gëzimin e paqtë.

Pasqyrat në dhomat e *Lebrozoriumit* kanë parë tmerre të denja për ferrin. Në çdo dhomë kishte nga një dhe që në orët e para të mëngjesit mund të dëgjonit sharje, ose pasthirrma të dhimbshme, provë se Hanseni një natë para e ka bërë punën e vet. Frika i bënte të sëmuret të mendonin se gunga në qafë është rritur, se një pjesë e hundës ka lëvizur majtas, ose lëkura e pëllëmbëve është bërë jashtë natyre e ashpër. Mundet vetëm të supozoni se çfarë ndodhte matanë syrit, sepse dhimbjen më të zakonshme të kokës mund ta shkaktojnë mendimet nga më të ndryshmet.

*Mycobacterium leprae*, pra, skaliste jo vetëm trupin, por edhe mendjen, duke e bërë nganjëherë të gjymtuar sikur-plagët e hapura në qafë dhe në kurriz. Është vështirë të presësh se në këto rrethana do të gjesh mirëkuptim dhe optimizëm karakteristik për fisin njerëzor, por nuk dua të them se një gjë e



tillë ka munguar në Lebrozorium. Ndoshta përmes shëmtisë trupore më lehtë shprehej ajo tjetra, e vendosur në qenien njerëzore.

Këto kritere në asnjë mënyrë nuk vlejné për shokun tim të dhomës Robert. W. Dunkan. Megjithë sëmundjen, ai e ruajti karakterin optimist, duke injoruar mashtrimet dhe kurthet e saj. Ai kishte fatin se bacili kishte një ecuri mjaft të ngadaltë, i cili ndiqte orën e pagabuar të natyrës, ose të Zotit, desha të them-shfaqej pikërisht në momentin kur mendoje se ndoshta je shëruar.

Në sajë të Robert W. Dunkanit, vitet e kaluara në Lebrozorium dukej se kalonin-më shpejt. R.W.D asnjëherë nuk harroi ditëlindjen time. Si dhuratë merrja gjëra krejtësisht sipas shijes dhe kërkesës sime. Më i shtrenjti midis tyre, albumi i bardhë i Bitëllsave, prodhim i Jugoton-it, do ta mbaj mend për gjithë jetën si shenjë e mirësisë dhe miqësisë së pastër. Më kujtohet sesi plaku Ingemar Zoltan, duke dëgjuar nga altoparlanti përhapjen e “Back in the U.S.S.R” bërtiste nga lumturia duke besuar se po dëgjonte marshin propagandistik, që transmetonte ultimatumin e tankeve rusë në rrugët e Budapestit. Çdo ditë duke marshuar nëpër korridore kërkonte të përsëritej dhe me gëzim bërtiste refrenin, i mbushur me parrullat e tij antisovjetike.

Dhuratate Robertit kishin shkëlqimin e paarritshëm të sendeve shumë të çmuara potencialisht intime. Duke i mbajtur nëpër duar kisha përshtypjen e

çuditshme se i kisha zotëruar një herë dhe tani po kthehen duke thirrur kujtime. Një palë letra Piatnik, një biçak me dorëz prej trung trëndafili, një akuarel i vogël kinez me kornizë ebaniti, një llullë turke-secila nga këto sende kishte një vend të veçantë në komodinë.

Refuzonte vazhdimisht të thotë se ku i gjen këto gjëra dhe unë pas disa përpjekjesh hoqa dorë nga insistimi, duke menduar se është fjala për ndonjë lloj talenti, si përshembull i shkrimtarit, ose talenti për muzikë. Disa ditë përpara ditëlindjes sime i ndoqa me kujdes lëvizjet e Robertit, por asnjëherë nuk e humba nga sytë për më shumë se gjysmë ore, çka ishte e pamjaftueshme për një dalje deri në fshatin më të afërt, apo drejt fabrikës së plehut inorganik. Herë pas here, gjatë shëtitjes në oborr vija re nënqeshjen e tij enigmatike, duke e ditur se unë po çaja trutë dhe që mezi përmbahesha t'i bëja edhe njëherë pyetjen, si?

Dhuratën që mora, më dy prill të 1989-ës, për ditëlindjen time të dyzet e dytë, nuk e kam mbajtur në komodinë, por thellë në dyshekun plot me lesh deleje. Roberti e kishte lënë pranë orës së tryezës, kështu që, kur e pashë, krahas-ziles hysterike të *Raketës* ruse, nga emocioni më tingëlloi edhe koka. Nuk isha i gatshëm për një shok të tillë, i cili, ditët e qeta pranverore i ktheu në një lumë dyshimesh, parashikimesh dhe shpresash. Njëkohësisht, portreti i madh i Nikollaj Çausheikut, i cili

prej vitesh buzëqeshte në murin e ndërtesës së administratës së fabrikës, ishte i lyer me katran, aq sa nuk njihej.

Duke përzier letrat shihja malet në perëndim. Evropa ishte atje pas majave të Alpeve të Transilvanisë, që zhytej në një natë tjetër. Dëgjoja si zhurmonte në rrjedhën e ujit duke dërguar sinjale të koduara. Kur Robert W. Dunkan u afrua pa zhurmë pas kurrizit tim dhe më preku supin, letrat fluturuan nga duart e mia të trembura drejt dritares. Dukej se po binin gjatë, shumë gjatë, duke fluturuar përmes ajrit të ngjeshur pranveror. Dija se diçka do të ndryshonte shpejt.

Roberti qeshte me duart e mia që dridheshin. Hapi me qetësi konservat e ananasit, kurse unë mendoja se në fakt po hapte dy kuti të Pandorës, nga një për secilin. Mëngjesit tjetër keni patur mundësinë të më shikoni sesi lëkundesha duke zbritur shkallët me konservën e mbushur me ujë për lulet; për narcizët e mrekullueshëm pranë murit jugor të *Lebrozoriumit*.

Por nuk ishin narcizët shkaku i vetëm i ngritjes sime para të gjithëve, në ditën e gjashtëmbëdhjetë të prillit, në vitin 1989.

## Kapitulli i dytë

Dhemb teksa gëlltis ananasin, ndërkohë Roberti thotë se kjo është vetëm një fazë kalimtare, pas së cilës vijon mekja totale e gurmazit, prandaj lebrozët në të kaluarën shpeshherë fitonin ca pará, duke gëlltitur copa prushi, ose duke ngrënë xhama. Thotë, se me kohë do të mësohem megjithëse do të më mungojë ngacmimi i këndshëm i çajit të nxehtë. Atij, më shumë i mungon nxehtësia përcëlluese e çajit të nxehtë Jim Beam, të cilin e adhuron. Roberti është amerikan. Mendoj se është i vetmi amerikan në planet, i infektuar me këtë sëmundje të rrallë. Miqve të paktë dhe një tetoje të vjetër, të moshuar në Gjeorgji u ka shkruar se ka AIDS dhe se pjesën tjetër të jetës do ta kalonte në Kontinentin e Vjetër. Dëshiron ta mbajnë mend siç ka qenë dhe jo si një hije të pafuqishme të ish-nën/oficerit të këmbësisë amerikane.

Në verën e vitit 1982 më tha se lebrën e kishte marrë në shtëpitë publike të Amsterdemit, por vazhdoi me ngut të ritregojë ngjarje nga stërvitjet në Arizonë. Për delikatesë nuk e ngacmova më me pyetje, megjithëse e dija se asnjëri nga fëmijët e

Hansenit nuk e shpjegonte historinë e sëmundjes me një fjali. Tregimi është i gjatë dhe gjithmonë i ndërtuar në mënyrë sa më të saktë. Aussätzig-ët, e tregonin sa herë që i pyesje, qoftë edhe larg e larg për prejardhjen e fatit të tyre. Gjithë të vërtetën, Roberti do ta tregonte vetëm vite pas ardhjes sime, i inkurajuar nga miqësia.

Narcisat të kujtojnë gjithnjë përrallën për bukurinë dhe pasqyrimin e saj. Nuk do të çuditësia në qoftëse ajo lule e mrekullueshme do të vyshkej më kot, para pamjes së fytyrës sime të shfytyruar. Megjithëse nuk kam mangësi kritike të pamjes, hunda ime, faqet dhe balli janë të mbuluara me lythe të mëdhenj. Leontiaza ka marrë vrrull dhe vetullat, qerpikët, flokët dhe mjekra kanë kohë që s'janë. Por, kërcyelli i hundës, është në gjendje mjaft të mirë. Për këtë kanë kontribuar dozat e rregullta të tiosemikarbazonit dhe preparatet antimone, të cilat, dikur, vinin me bollëk. Mund të shpoheshe sa herë të doje. Para mëngjesit, pas drekës, në agim, ose gjatë natës. Shumica e të sëmurëve e përvetësonte këtë regjim pa ditur se ishte thikë me dy presa. *Mycobacterium leprae* fitonte shumë shpejt imunitet ndaj medikamenteve dhe duheshin doza elefanti që, të paktën, përkohësisht të ndalej përparimi i bacilit. Me ndihmën e Robertit merrja me saktësi dozat e medikamenteve, ç'ka rezultoi për një kohë të gjatë kalimin e Hansenit në gjendje të fjetur. Në vitin 1984 u zhdukën ampulat e fundit

të substancave të çmuara. Atëhere ndërruam orientimin e terapisë me bimët mjekësore, të cilat mund t'i mblidhje në rrethinat e afërta. Disa libra rusë në këtë fushë ndihmuan për të zbuluar shumë shpejt çajrat më të efektshëm për qetësimin e edemave dhe gungave të sëmura. Kompresat me gjethe manushaqe vepronin mirë për të qetësuar mesiguri kruajtjen e padurueshme, e cila shfaqej në ditët me shi, herë-herë duke i shtyrë të sëmurët që të bënin nga trupat e tyre të dënuar vullkane të vërteta gjaku dhe qelbi. Me tridhjetë gram idhnakth të kërcejve të rrjepur dhe të prerë imët, hedhur në një litër ujë të vluar përfitohej një çaj jashtëzakonisht i hidhur për lehtësimin e dhimbjeve në fyt dhe gurmazit. Korja e re e vidhit gjendej në pyllin e afërt gjatë gjithë vitit. Vetëm kjo bimë, përmbante direkt krahas emrit të vet edhe sugjeronin sa i përket qetësimit të simptomave të lebrës, ç'ka e bënte më të njohurën mes të sëmurëve. Merr lëkurën e kërcellit dy-vjeçar, e than në erë dhe në diell dhe e pret imët. Në njëzet litra ujë përgatisnim një kilogram e treqind gramë, derisa sasia e lëngut nuk përgjysmohej duke avulluar. Çdo mëngjes duhej të pije 200 gram dhe po aq të harxhoje për kompresa. E përgatisnim në dy kazanë të mëdhenj, ulur pranë zjarrit, në mes të oborrit. I moshuari Ingemar Zoltan kishte njëfarë prirje kulinare, kështu që shkathtësia e tij rreth përgatitjes së bimës u bë një punë rutinë. Vendosnim autoparlantin në dritare,

vendosnim drutë, secili merrte një stol të vogël, ose ndonjë cung; shfaqja fillonte. Ndërsa “Albumi i bardhë” i Beatleas-ave rrotullohej çdo natë, duke bërë që gjunjtë e ngurtësuar të tundeshin lehtë, cifla të djegura fluturonin drejt gjithësisë, përcjellë nga sytë e zbehtë të lebrozëve.

Ndonjëherë Roberti merrte një copë dru në vend të mikrofonit dhe luante të mrekullueshmen Happiness is a warm gun. Arrinte të zhvaste buzëqeshje të prekshme, që fytyrat e rrudhosura i kthente në portrete groteske të brengës sonë. Muzika ulej kur biseda ndizej. Nën kapuçët prej liri vinin zëra të ngjirur; tregoheshin histori të jetëve të shkuara, rrëfimet për jetën e fatkeqëve, të cilët, si magjistarë kërkonin pamje dhe fjalë të humbura në harresën e errët të largët. Aasnjëherë nuk pyeste askush. Mund të tregoje pa u shqetësuar nga ndërprerjet dhe mosbesimi, sepse secili nga të pranishmit e dinte se do të ndodhej në një situatë të ngjashme.

Biografitë e vërteta ishin të paprekshme. Me hyrjen në Lebrozorium merreshin në mënyrë brutale të gjitha dokumentet, gjërat personale dhe veshjet, në këmbim merreshin ca veshje të brendshme, dy palë këmbisha të bardha, një kapotë ushtarake dhe një rrobë cilësore liri me një kapuç të madh. Rezervat rinovoheshin vazhdimisht, kështu që askush nuk mund të ankohej për mungesë të higjienës. Ndërsa tre doktorë, të pranimit të ushtarëve në ushtrinë

rumune, formalisht të sjellshëm, më përgatisnin për qëndrimin në Lebrozorium, unë prisja se do të më varnin në qafë edhe një zile, si rekuizitë e duhur për lebrozin në kohët e shkuara, i cili paralajmëronte se ishte duke kaluar rrugës. Ai, të cilit i është refuzuar dashuria e Zotit. Për fat, kjo nuk ndodhi. Por, procedura e tyre e mësuar tingëllonte me një vendosmëri të frikshme. Kuptova se nuk po shkoja për mjekim, por më përgatisnin për diku tjetër, ku mungojnë rregullat e kësaj bote, që më shpejt mund të quhej të dergjesh në izolim, sesa trajtim mjekësor. Desha të mbaj orën, pasaportën dhe një varëse prej floriri, të shigjetarit. Kur përmenda atë mundësi, njëri nga mjekët tha me një buzëqeshje të butë se, gjërat do të jenë më të sigurta, nëqoftëse do të mbeten tek ata, deri sa të shërohem.

Në të njëjtën kohë një koleg i tij i rraste në një enë të madhe prej teneqeje, kurse tjetri, me maskë në fytyrë u hidhte përsipër një përzierje pluhuri të bardhë. Dy gjilpëra të mëdha u zhytën në kofshën time të majtë, duke më injektuar një antidepressiv të fortë dhe dozën e parë të tiosemikarbazonit. Mjeku lëvizi zeron në numërorin e zi dhe pëshpëriti në receptor: është gati. Më futën në një makinë të shkatërruar spitali. Tentova të flas, por fjalët, nën veprimin e injeksionit ktheheshin në lëvizje të buta duarsh, ose në vetullngrysjë. Gjuha vërtitej në gojë, duke bërë që pështyma të rridhte çurg në mjekër, deri në dysheme. Mbështeta fytyrën në xhamin



e derës së pasme, lidhur me tel. Stacioni i vogël ambulant, në periferinë e skajme të Bukureshtit mbeti si një pikë e bardhë, me njollën e kryqit të zi në mur. Një njeri, që nuk u duk gjatë vizitës, doli jashtë dhe u mbështet në mur. Në shenjë përshëndetjeje lëvizte lehtë dorën, ndërsa po largoheshim. Me jakë të gjerë të kostumit të zi, me xhaketë prej lëkure të hapur, me një palë mustaqe të ujdisura me merak dhe me dhëmbë të bukur. Disa minuta më parë, ky i ngrefuri i veçantë dëgjoi fjalët e doktorit-është gati- dhe i kënaqur ndezi cigaren. Ndërsa largoheshim, vazhdonte ta mbante në dorën e majtë.

Rrugës për në Lebrozorium, duke kaluar nëpër zabele të prishura, rrija ulur në një stol prej druri, mbështetur në murin prej llamarine. Xhami me rrjetë, i madh sa një ekran televizori, rrezatonte të sfumuar peizazhin e zbehtë dimëror pa dëborë. Fshatarët, në fushat moçalore, të mbështetur në veglat e punës, përcillnin me sy makinën. Një fëmijë, shumë i shëmtuar, vrapoi drejt makinës dhe hodhi një gur, duke goditur llamarinën e trashë. Për një moment, shoferi ngadalësoi duke ia kthyer me disa sharje rumune, pastaj u kthyem djathtas, në pyllin me mështekna, i cili më vinte në gjumë me lëvizjen e lehtë të trungjeve të bardha, që përkuleshin nga era e veriut.

I ngrefuri i veçantë do të shpjegonte R.W.D ishte oficer i së famshmes Securitate, i emëruar jo shumë

kohë përpara që të përgjigjej për të gjithë lebrozët në territorin e republikës. Kujdesej që të sëmuret të shkonin në vendin e caktuar, por dhe të mbeteshin atje, ç'ka ishte po aq e rëndësishme.

Procedura e mjekimit të lebrëz nuk ka ndryshuar shumë ndër disa shekuj të regjistrimit të ekzistencës së saj. Për të shmangur përhapjen drastike të infeksionit duhej të zbatoheshin dy kushte: 1. të kufizohej rreptësisht lëvizja e të sëmurve. 2. të shmangej kontakti me njerëzit e shëndoshë. Kështu ishte në kohën e Ramsesit II, Karlit V, apo të Ivanit të tmerrshëm.

Në mesjetë, nganjëherë lebrozët i çonin në turr. Kjo, vetëm për t'i treguar popullit natyrën jo hyjnore të infeksionit dhe të të infektuarit.

Meqënëse as kisha nuk tregonte mëshirë, Aussätziger-ët ishin të detyruar të krijonin bashkësi në periferi të vendbanimeve, duke kërkuar shpëtim në mbeturinat, bimët kurative mjekësore dhe frutat e thata të pemëve të egra. Nganjëherë kolonitë bëheshin nervoze dhe hordhitë e lebrozëve shpesh herë plaçkisnin fshatrat e vegjël përreth dhe udhëtarët që shkonin në qytet. Kjo vazhdonte për disa javë, apo muaj, në varësi të gadishmërisë së personaliteteve të qytetit, t'u hipnin kuajve, të ndiznin urrat dhe të niseshin në një kryqëzatë të vogël kundër bijve dhe bijave të djallit.

Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, shembulli i Sensotregiores, qytetit me tetë mijë banorë, rreth

100 kilometra larg Firences, ndikoi mjaft për të ndryshuar qëndrimin ndaj lebrozëve. Kolonia e të infektuarve, e vendosur afër kështjellës së qytetit, u formua në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë në kohën e Papa Inoçentit VIII. Me klimën e butë dhe të thatë, ajo ishte bërë e njohur në mes të lebrozëve të Evropës Jugore dhe jo rrallë, në të vinin dhe të sëmurë nga skajet e largta të Skandinavisë, Spanjës dhe Mbretërisë Britanike. Mjekët popullorë, stallat e braktisura të ushtrisë dhe rrugët me lëvizje, në të cilat çetat e lebrozëve grabisnin para dhe ushqim, ishin bërë faktorë për popullimin e kësaj kolonie, në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, me dy-tre mijë të sëmurë. Kur, një grup kolonësh përdhunuan në mënyrë brutale tri vajza minorene, gojëdhëna thotë se i kanë therrur dhe i kanë ngrënë gjatë orgjisë së po asaj nate, priftërinjtë e qytetit me bekimin e Papës kanë mbledhur dyqind mercenarë të armatosur rëndë: një ushtri me synim largimin dhe përgjakjen e vëllazërisë së shfrenuar. Konflikti i ndjekur me britma të tmerrshme vazhdoi deri në orët e para të mëngjesit dhe kur dielli lejoi të shihej qartë në vendin e betejës, banorët kureshtarë dhe hakmarrës të Sensotregiores, mund të shihnin ushtrinë e rreshtuar të lebrozëve, me kokat e armikut në duar. Ata panë hordhinë e egërsuar, e cila ulërinte si e çmendur, duke përparuar drejt portës së dobët të qytetit. Për më pak se dy orë Sensotregiore u bë Sodoma e pushtuar nga

zemërimi i të uriturve dhe të shëmtuarve. Të gjitha kënaqësitë e kësaj bote, mohuar me vite u shndërruan në instinkte brutale të të përçmuarve. Përdhunime, grabitje, orgji të neveritshme, vrasje të vrazhda mbushën rrugët e qytetit, duke i kthyer në pishtarë tmerri. Mbetur pa mend nga frika e sëmundjes, populli vraponte drejt portave të veriut edhe më tutje drejt kodrave.

Lebrozët, shumë shpejt pushtuan qytetin duke pushtuar shtëpitë komode të personaliteteve. Në mesditë, në sheshin kryesor u varën katër anëtarë të këshillit të qytetit; u zgjodh kryetari i bashkisë dhe *Sensotregiore* u bë njëfarë *Lebropolis*, një bashkësi e fuqishme, e cila ka funksionuar mirë në sajë të mjeteve financiare të mbledhura me kujdes nga vendet e fshehta, dysheqet dhe arkat e shtëpive të pasura. Sigurisht, nuk ekzistonte një ushtri e gatshme të sulmonte qytetin ku sundonte lebra. Por, kolonitë e tjera të lebrozëve nëpër Evropë ishin ndëshkuar në shenjë hakmarrje për *Sensotregiores*. Kasollet prej druri digjeshin pa mëshirë, ndërsa çdo ushtar kishte lejen e heshtur të vrasë, ose të lerë gjallë lebrozin, si t'ia thoshte mendja. Vetëm një dekadë pas krijimit të *Lebropolisit*, kur sëmundja kishte dërguar në varr më shumë se dy të tretat e banorëve të tij, para portave të qytetit, mbrritti një armatë prej treqind kalorësish dhe po aq këmbësorë të armatosur mirë, të vendosur të sillnin rendin e Zotit në Sodomë. Mes ushtarëve

kishte dhe një numër të konsiderueshëm ish-banorë të Sensotregiores të mëkuar me zemërim të ligjshëm dhe urrejtje të madhe. Lebrozët, të paralajmëruar nga fanfarat dhe zhurma e armëve u larguan vullnetarisht nga qyteti dhe shkuan në mal, të ndjekur nga shpatat e fituesve. Ky ka qenë tregimi i preferuar i Robertit, të cilin ai shpesh herë, me kërkesë të të tjerëve e ritregonte pranë zjarrit. Asnjëherë nuk harronte në fund, pas një pauze dramatike, të kujtonte se edhe sot e kësaj dite, nëse do të kalonit pranë kështjellës gjysmë të shkatërruar të kësaj qyteze italiane, mund të dëgjonit britmat e vëllezërve tanë të lajthitur dhe të zhytur në mëkat.

Mjeku më shkundi me forcë kur mbrritëm para portës së Lebrozoriumit. Më dha një pako me sende të higjienës personale, ndërsa shoferi më ofroi një cigare. Po ta kisha marrë mendoj se do ta hidhte me dy gishta nga dritarja, gjysmë e hapur. Nga ana tjetër e gardhit prisnin Zoltani i moshuar dhe R.W.D. Njerëzit e parë, që pas disa muajsh, më shtrënguan dorën. Ecnin mbi shtresat e trasha të gjetheve të rëna, duke kapërcyer vendet me akull. Ndërtesa kishte tre kate me tavane të lartë. Në disa dritare me dritë të zbehtë përvijoheshin silueta të errta të të sëmurëve. Kati i tretë në fakt kishte vetëm hapje të vogla ventilimi dhe shërbente si magazinë. Dhoma ishte e ngrohur mirë, ndërsa pranë sobës së gurtë në qoshe ishin rreshtuar disa krahë dru, të

prera shkurt. Mbi komodinë lule, në murin sipër shtratis riprodhim i “Trapi i Meduzës”<sup>1</sup> dhe një kryq tek koka. Robert W. Duncan dukej se u gëzua mjaft me njohjen time solide të gjuhës angleze, prandaj fliste i kënaqur duke shpjeguar se vendi ku do të kaloja vitet në vijim do të ishte shtëpia ime e vetme. Pasi më tregoi se ku ndodhej banja, më la të rregulloja gjërat. Darka është në tetë e tridhjetë, mensa në katin përdhes. Tentova të shquaj në errësirën përtej dritares, në rrethinën, por nuk munda të shoh asgjë përveç dritave regëtuese violet të fabrikës së plehut inorganik.

Korridoret e ndërtesës kishin formën e gjysmëmehënës. Po të rrije në mes nuk mund të shihje asnjë nga fundet. Në fillim kjo më shqetësonte dhe shpesh herë shkoja në drejtimin e gabuar, deri tek dera e mbyllur, mes shkallares që të çonte në tavan. Në mensë më priste një tryezë jashtëzakonisht e madhe, e rrumbullakët, e shtruar me pjata dhe takëme të njëllojta, mbi të cilat ishin përkulur kapuçët e errët të të sëmurëve. Kur hyra u dëgjua një zhurmë e lehtë e përzemërt, në gjuhë dhe dialekte të ndryshme, por askush nuk u ngrit për të përshëndetur. Zoltani i moshuar më tregoi karrigen bosh pranë tij, ndërsa Roberti në çast filloi prezantimin, si u shpreh ai, të kolegëve me të cilët do të ndaja të mirat dhe të këqijat. Me të dëgjuar emrin e vet, njerëzit përgjigjeshin me heqjen e kapuçit. Njëri pas tjetrit zbuloheshin

1. Vepër e Théodore Géricault, piktor dhe litograf francez.

kokat e gdhendura nga sëmundja: Përzierje të përçudnuara indesh të shpërndara mbi kafkë. Drita tregonte përbindshëm, ndërkohë që flisnin me zëra normalë, ç'ka jepte përshtypjen se kishin në fytyrë maska të tmerrshme. Atëherë edhe unë e hoqa kapuçin.

Nuk mund të them se kisha ende shenja të fytyrës rozë, por lëkura ime vazhdonte të ishte mjaft e tërhequr me një ashpërsi të parëndësishme, shkaktuar nga fillimi i lebrëz. Në qafë më pulsonin damarët e muskujve-dëshmi të shëndetit të dikurshëm-ndërsa flokët sapo kishin filluar të binin. E gjithë kjo shkaktoi një minutë zilie të fshehtë dhe mosbesimi. Heshtjen e ndërpreu Roberti që zgjati dorën drejt enës vezake, me perime të ziera. Mbushi pjatën time.

Vendosëm kapuçat dhe vazhduam të hamë. Darka kaloi e shoqëruar me një pëshpëritje të lehtë, të mbytur edhe nga veshjet e lirta. Edhe të tjerët më ofronin ushqim, pa munguar të më shihnin në sy, në duar, duke kërkuar shenjat eksplicite të sëmundjes. Mund të shihnin fillesat e gungave të dala në kyçet e gishtave dhe hijen e kataraktit të syrit. Mund të shihnin lotët që i shkëlqenin në sy të dëshpëruarit, pikat që fiken dhe thahen në sy, që nuk rrjedhin. Gjendja po përmirësohej nga pak: u pranova në shoqëri si anëtar me të drejta të barabarta të bashkësisë.

Më vonë, në dhomë, R.W.D provoi të zbusë frikën

time, shkaktuar nga takimi i parë i rëndësishëm. Më shpjegonte sesi tashmë lebra nuk mund të përparonte më shumë sesa është; më fliste se do të merrnim rregullisht terapinë e tiosemikarbazonit dhe do të zbusnim efektivisht pasojat. Nuk ndaja të njëjtat shpresa. Një tjetër kqyrje të kolegëve gjatë mëngjesit më bëri të kuptoj se çfarë përbindëshi pa kompromis mbaja në trupin tim.

Po shihja sesi ndryshojnë fytyrat e tyre ndërsa përtypin vezë të skuqur. Grumbujt e mishit të pajetë tundeshin si topa budingu duke shkëlqyer nga yndyrnat. Gishtat e sakatuar ngjajnë si copa të kallajit të shkrirë, ndërsa sytë e rëna hedhin reflekse drite të dobët, e cila, mezi i prek. Kishte nga ata që, për një çast ndërprisnin drekën për të nxjerrë copëza ushqimi nga vrimat e hapura të hundës, të përcjellë nga një pakënaqësi e zhurmshe, prandaj fatkeqi pa hundë detyrohej të ngrihej nga tryeza dhe të përfundojë punën e pisët në një vend të fshehtë. Banori më i vjetër i Lebrozoriumit të fundit në Evropë ishte Ingemar Zolta, i cili ishte këtu që nga hapja e tij, në vitin 1928. Ishte i vetmi që i kishte mbijetuar pushtimit gjerman dhe vrasjeve masive, ku të gjithë 47 Aussätziger-ët ishin nxjerrë në fushë dhe me një breshëri ishin hedhur në gropën e madhe moçalore.

Kujtonte zhurmën e makinave të blinduara, të 14 dhjetorit 1942, shkatërrimi i portës së hekurt dhe ushtarët e rinj të divizionit Princ Eugen të vendosur



të... O, Zot! Të vendosur për çdo gjë. Katër të rinj me skafandra gome vrapuan nëpr korridoret e ndërtesës, duke urdhëruar lebrozët e përgjumur t'u jepnin këmbëve dhe menjëherë të dilnin në oborr. Vraponin njëri pas tjetrit duke fërkuar sytë. Zoltani shpjegonte se ardhja e gjermanëve nuk shkaktoi panik të madh. Më shumë ishin çuditur, sepse në Lebrozorium atëhere nuk dinin saktësisht se çfarë ndodhte në botën jashtë. Supozonin se ky ishte vetëm fillim i numërimit statistikor poshtërues, të cilin pushteti e kryente çdo vit nga frika e arratisjes të të sëmurëve dhe shkaktimit të epidemisë. Fakti se në oborr kishte ushtarë gjermanë, të armatosur deri në dhëmbë ka qenë fundja një arsye më shumë për shpresë, se më në fund, dikush do të vendosë pak rregull dhe kujdes të vërtetë mjekësor në realitetin e dëshpëruar të kolonisë. Por, kur oficeri kryesor tregoi me shmajzerin portën dhe kur të parin në rreshtin e lebrozëve e shtynë me tytën ndër brinjë që të niset, Zoltani kuptoi qartë se po përgatitej diçka më shumë se një terapi e zakonshme mjekësore, apo rinumërim i mërzitshëm. Breshëria një minutshe e konfirmoi dyshimin. Fshehur midis dy vidhesh dy-vjeçarë, jo larg gardhit, Zoltani lëshonte lotë të mëdha dhe të ftohta që binin në tokë. Edhe ai donte të ishte me vëllezërit, të ishte pranë trupave të tyre dhe kështu të mbaronte jetën e shkretë të lazaretit në skajin e fundit të Rumanisë. Gjermanët bënë një dezinfektim me themel të ndërtesës, duke

djegur në oborr gjithçka që mund të digjej. Disa portrete të vlefshme të mbretëreshës rumune Marie u zhdukën në flakë bashkë me copat e mobiljeve të shtrenjta dru arre, sjellë në Lebrozorium bashkë me portretet si dhuratë. Zoltani shikonte zjarrin e madh i cili gëlltiste me kujdes kujtimet e famshme të kurorës. Fotografi të të afërmëve, gjëra të vogla, por të rëndësishme, të vendosura nëpër sirtarët pranë kokës së të sëmurëve janë zhdukur mes gjuhëve të kuqe të zjarrit gjerman.

Atë mëngjes, tregonte Zoltani, u dogj edhe dyshimi i fundit se bota, kjo tokë dhe ajo andej prapa malit, e cila gumëzhin si një mbretëreshë blete e ngjallur duke dërguar sinjale të koduara, mund të bëhet vend i denjë për dashurinë e Zotit.

Deri në fund të luftës, Zoltani mbeti pyjeve përreth, fjeti në stallat e braktisura dhe shtëpitë e djegura. Gjermanët vendosën në Lebrozorium shtabin e tyre të ruajtur mirë, kurse në oborr përveç rojeve, patrullonin edhe tre qen-ujq. Nuk guxonte të afrohej.

Mëngjesin e shtatëmbëdhjetë prillit 1944 e priti në pularinë e qelbur, jo shumë larg rrugës kryesore. E zgjoi po ajo gumëzhimë e makinave të rënda dhe fonemat e mprehta si teh të gjuhës gjermane. Priti të kalojë ushtria dhe u nis me hapa të shpejta drejt Lebrozoriumit. Në obor ngrihej zjarri në të cilin digjeshin sende të ushtarëve gjermanë, duaj me dukumente plot, spaleta gradash dhe portrete të

mëdha të Adolf Hitlerit. Godina ishte e paprekur. Me përjashtim të kumbarave të mëdha, në murin përballë lyer me zift para largimit, nuk binte në sy asnjë lloj shkatërrimi. Përkundrazi. Dritaret ishin rregulluar, banjot përmirësuar dhe në çdo dhomë ishte ndërtuar nga një sobë e vogël prej guri. Një bufë e thjeshtë e madhe zbukuronte mensën që shkëlqente nga pastërtia, ndërsa në kuzhinë akoma ndihej era e drekës së fundit. Enët me shenjën Rejcha shndrisnin nga vitrinat. Zoltani i prekte me gishtat e tij të shtrembëruara duke shikuar fytyrën e vetë në sipërfaqen e bardhë të porcelanit.

Në një kënd të mensës dukej gramafoni. Ai mori një nga pllakat e hedhura në tokë e pështolli zemrekun dhe uli me kujdes gjilpërën mbi vijat e zeza të Koncertit për Piano të Grigut. Muzika tingëlloi ndërkohë që ai po vishte kapotën e vetme të mbetur, varur në koridor duke këputur spaletat dhe Kryqin e hekurt nga gjoksi. *Alegro molto moderato*: ngemar Zoltan shkoi nga muri jugor për të gjetur ndoshta narcisa që zakonisht dalin atje në këtë kohë të vitit. *Adagio*: dhe Zoltani mbledh ethshëm narcisat duke i këputur nga rrënjët. Lotët e tij të ftohta tani po pikojnë mbi buqetat e lidhura. *Alegro molto e marcato*: Vendosi lehtë lulet mbi grumbullin rrethor të dheut jo shumë larg Lebrozoriumit. *La mort d'Ase*: Shtrihet mbi tokën e ngrohtë pranverore, mbi atë tokë ku dergjen trupat e bërë dhé të vëllezërve të tij lebrozë.

Mizat e dheut po gostiteshin me pisllekun e mpiksuar në trupin e Zoltanit duke çuar ato kafshatëza të shijshme në kanalet e poshtme të shtëpisë së tyre nëntoksore. Pas një gjumi disa orësh, ai është larë, ka lidhur plagët me fasho të pastërta dhe përsëri ka shkuar në vendin e prehjes së miqve të tij të vdekur. Në vend të lutjes ka lexuar mbi varrin e tyre kapitullin e pestë nga Libri i dytë i mbretërve në të cilin Eliseu shëron lebrozin Neman të Sirisë dhe ndëshkon Gieziun me këtë sëmundje. Nuk është e vështirë të kuptohet kë ka patur parasysh Zoltani ndërsa shqiptonte mallkimin e Dhjatës së Vjetër. Nëse e pyesni përse ka vendosur të kalojë fundin e jetës së tij në Lebrozorium, ngre dorën dhe thotë pa kokëçarje: Pres vdekjen të vijë dhe ky vend është i vetmi ku mund ta pres pa u penguar. Në shenjë përkujtimi të paraardhësve tanë të vdekur nga kjo sëmundje, çdo 14 dhjetor jepej një drekë përkujtimore me një minutë heshtjeje dhe lutjen e përbashkët në varrin masiv. Pasi të përsëriste krejt historinë, Zoltani fshinte lotin me të vetmin gisht të shëndoshë që kishte dhe shkonte të pushonte. Ne shpërndaheshim të mallëngjyer me ndjenjën e krenarisë së ëmbël për faktin se lebrozët, qoftë dhe përmes ekzekutimit kolektiv kanë qenë gjykatës së Luftës së Dytë Botërore. Sikur për një çast imagjinata e Zoltanit të çlirohej nga prangat e dokumentarizmit, plaku mund të tregonte sesi i strukur pas pemëve ka dëgjuar

britmat e atyre që ishin gati të vdisnin, të cilët kanë nisur të këndojnë Internacionalen në gjuhë të ndryshme, ndërprerë, le të themi nga të shtënat, në strofën e dytë. Duke qenë dëshmitari i vetëm, pas luftës pushteti komunist, i etur për mite heroizmi, do ta kishte rrokur me endje dhe pa të keq.

Afër Lebrozoriumit do të ngrihej një memorial i bukur, ndërsa godina mund të ishte pajisur me ngrohje qendrore.

Ndërsa mbledh narcisët me duart e mi të ashpra kthej kokën majtas dhe djathtas për t'u bindur se këtë mëngjes jam lebrozi i vetëm i zgjuar. Kërcyejt e njomë kërcasin duke përfunduar në ujën e ftohtë brenda kutisë së konservës së ananasit. Dhurata e ditëlindjes e Dunkan-it është fshehur në xhepin e brendshëm. Shtatë narcizë. Guri i shtatë nga e majta, rreshti i gjashtë nga poshtë. Fus një dru, e nxjerr gurin nga shtrati për ta kapur dhe e tërheq. R.W.D.-ja më pat këshilluar ta shtrëngoj më kujdes dhe pastaj ta tërheq lehtë. Kërcet si rrotë e vjetër, them me vete, megjithëse s'kam qenë kurrë në ndonjë mulli. Është më i rëndë sesa kam menduar. E vendosa tek këmba, mbërtheva mëngën e djathtë dhe zhyta dorën me droje në vrimën e errët. E ftohta e murit të vjetër më përplasat në fytyrë, pres prekjën e diçkaje. Por asgjë. Përveç atij të ftohti dhe erës së myshkut nuk ndiej asgjë. Pastaj nxjerr dhuratën e Robertit nga xhepi dhe e vë në atë errësirë, vendos bllokun prej guri dhe e shtyj me

forcë. Marr konservën me kujdes dhe kthehem në dhomë. Isha i emocionuar sikur në atë çast kisha mbjellë në mur një far magjik paditur se çfarë bime përbindëshi do të mbijë.